



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

ORGANIZOJNË, ELBASAN 24-25 QERSHOR 2022

KONFERENCËN E 2^{të} NDËRKOMBËTARE

"Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor"

NË BASHKËPUNIM ME



Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si Universiteti i Tiranës, Universiteti i Barit "Aldo Moro", Universiteti i Foggia, Instituti i Dizajnit i Materas, Universiteti Complutense i Madridit, Universiteti Pontificia de Comillas, Universiteti i Lisbonës, Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë, Universiteti "Eqerem Çabej" Gjirokastrë fton lektorë, specialistë, kërkues shkencorë dhe studiues për të marrë pjesë në konferencën e dytë ndërkombëtare "Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor".

Tematikat kryesore të sesioneve të kësaj konference do të jenë të fokusuar dhe do të trajtojnë studime/referime/raste studimore në fushat e mëposhtme:

1. Cilësia në arsimin e lartë
2. Politika dhe lidhshiri arsimor
3. Gjithëpërfshirja dhe diversiteti
4. Globalizimi digjital
5. Shërbimet psiko-sociale në edukim
6. Tregu i punës në arsim
7. Edukimi dhe artet
8. Kurrikula dhe mësimdhënia në arsimin parauniversitar
9. Vlerësimi në arsim
10. Zhvillimi profesional
11. Të mësuarit gjatë gjithë jetës
12. Marrëdhëniet e edukimit, medias dhe etikës

Konferenca do t'i kushtojë një sesion të veçantë pjesëmarrjes së studentëve, të cilët do të kenë në fokus të prezantimit të tyre kërkimin shkencor.

Konferenca synon të bëjë sërish bashkë studiues nga fusha e edukimit, akademikë, drejtues dhe mësues të sistemit të arsimit parauniversitarë, specialistë psiko-sociale dhe studentë për të ndarë, diskutuar dhe trajtuar këndvështrimet e reja mbi profesionin e mësuesit, praktikave të mësimdhënies, politikave arsimore parauniversitare dhe universitare, modelet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësuesin, bazuar në pritjet dhe të rehat më të fundit të kërkimit në fushën dhe në shkencat e edukimit, sfidat me të cilat po përballemi aktualisht, si dhe perspektivat në fushën e edukimit bashkëkohor.

Nevoja për të analizuar cilësinë e arsimit në vend, procesin e dixhitalizimit të mësimdhënies, shërbimet psiko-sociale në shkollë si dhe programet e mësimdhënies në fakultetet e arsimit në vend do të jenë shtyllat kryesore të kësaj konference shkencore.

Informacione për pjesëmarrjen në konferencë

- Data të rëndësishme

Dërgimi abstraktit	15 Maj 2022
Njoftimi për pranimin e abstraktit	20 Maj 2022
Dërgimi i artikullit	25 Maj 2022
Data e konferencës	24-25 Qershor 2022
Vendi	Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan
Gjuha zyrtare e konferencës	Shqip, Anglisht
Tarifa e pjesëmarrjes	2 000 Lekë për një autor; 1 000 Lekë për çdo bashkëautor
Koha e prezantimit	10-15 minuta
Adresa zyrtare	konferencashe2022@uniel.edu.al

- **Hapat për prezantimin e punimit:**
 - Zgjidhni sesionin në të cilin dëshironi të merrni pjesë.
 - Dërgoni abstraktin në adresën e-mail: konferencashe2022@uniel.edu.al
 - Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit
 - Prezantimi i artikullit në ditën e konferencës.



- **Formati i prezantimit të abstraktit**
 - **Author's name:** autor's full name (authors), status, insitution, e-mail address (12 points Times New Roman)
 - **Emri i autorit:** Emri i plotë i autorit (dhe i bashkëautoreve), titulli ose grada shkencore, institucioni, adresa e e-mailit (12 points Times New Roman)
 - **Fusha e studimit:** (sipas tematikave të sipërpërmenduar të konferencës)
 - **Abstrakti:** Abstrakti duhet të përmbajë 200-250 fjalë, dhe të paraqesë qëllimin dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe rekomandimet (12 points Times New Roman, Justified, Single-space)
 - **Fjalët kyçe:** 3-6 fjalë (12 points Times New Roman, Italic)
 - **Formati:** Microsoft Word (97-2003)
- **Materialet e konferencës:** Punimet e konferencës do të publikohen në "Proceedings", ku përfshihen programi, libri i abstrakteve, organizatorët, sesionet e konferencës, indeksi i pjesëmarrësve, etj. Në fund të prezantimit, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë.

Ju mirëpresim në Elbasan!